



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.52/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj dhe anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 22.06.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.52/2026, e datës 19.06.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 19.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën, ZP.Anr.52/2026, të parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit, ka konstatuar mospërputhje të evidentuara gjatë procesit të numërimit dhe për këtë arsye ka urdhëruar rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta. Sipas ankuesit, vetë fakti se janë konstatuar gabime në këto vendvotime dëshmon se numërimi fillestar nuk ka qenë plotësisht i saktë dhe krijon dyshim objektiv se pasaktësi të ngjashme mund të ekzistojnë edhe në vendvotime të tjera që nuk janë përfshirë në rinumërim. Ankuesi thekson se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në numrin e votave preferenciale të kandidatëve, përfshirë edhe gjashtë vota shtesë në favor të tij, ndërsa diferenca ndërmjet tij dhe kandidatit të renditur para tij mbetet 102 vota. Sipas tij, duke pasur parasysh rëndësinë e çdo vote në përcaktimin e renditjes së kandidatëve dhe

ndarjen e mandateve, ekziston nevoja që të verifikohet në tërësi saktësia e numërimit të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK.

Ankuesi konsideron se integriteti i procesit zgjedhor, parimi i sigurisë juridike, e drejta për zgjedhje të lira dhe demokratike, si dhe nevoja për garantimin e vullnetit të zgjedhësve imponojnë rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Pala ankuese kërkon që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit z. Bekim Haxhiu, kandidat për deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, me numër rendor 109, të Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe të zhvillojë rinumërimin e plotë të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës për kandidatët për deputet nga të gjitha vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300/2026.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përgjigjen e paraqitur pranë Panelit, ka kërkuar refuzimin e ankesës si të pabazuar. KQZ ka sqaruar se procesi i verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave preferenciale të kandidatëve është zhvilluar në të gjitha Qendrat Komunale të Numërimit në përputhje me legjislacionin zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi. KQZ ka theksuar se rinumërimi i 185 vendvotimeve nuk është urdhëruar si rezultat i konstatimit të parregullsive sistematike në procesin e numërimit, por në bazë të mekanizmit kontrollues të paraparë me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Sipas KQZ-së, me vendimin e datës 17.06.2026 është miratuar rekomandimi për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7.41% e gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit. KQZ ka theksuar se rezultatet e rinumërimit nuk kanë evidentuar ekzistimin e ndonjë modeli sistematik të pasaktësive, pasi ndryshimet janë evidentuar në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh kanë fituar vota ndërsa kandidatë të tjerë kanë humbur vota. Gjithashtu, ankuesi nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi apo qendër numërimi jashtë mostrës së rinumëruar dhe nuk ka paraqitur prova konkrete që do të mbështesnin pretendimin se pasaktësi të ngjashme ekzistojnë edhe në vendvotimet e tjera. Për këto arsye, KQZ konsideron se nuk ekziston bazë faktike dhe juridike për urdhërimin e rinumërimit të plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK. Në përgjigje në ankesë kërkohet që të hedhë poshtë ankesën, si të paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 105 të Ligjit Nr. 08/L-228, të konstatojë se ankuesi nuk ka paraqitur pretendime konkrete dhe prova të mjaftueshme për parregullsi në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të ankesës, përgjigjes në ankesë dhe provave të administruara në shkresat e lëndës, Paneli gjen se ankesa është e pabazuar.

Paneli fillimisht konstaton ankesa e parashtruar nga ankuesi është e lejuar dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit të parapare ligjor, pasi që rinumërimi ka përfunduar me dt.19.06.2026, në ora 12 kështu që ankesa është paraqitur po atë ditë me dt. 19.06.2026.

Paneli gjen se me vendimin e datës 17.06.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar në bazë të neneve 63, 64 paragrafi 2.1 dhe 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, ka miratuar rekomandimin për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta.

Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se rinumërimi është urdhëruar si pjesë e një mekanizmi kontrollues të paraparë me legjislacionin zgjedhor, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit dhe jo si rezultat i konstatimit paraprak të parregullsive sistematike në procesin e administrimit dhe numërimit të votave.

Paneli vlerëson se qëllimi i mekanizmit të paraparë me nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2026 është pikërisht verifikimi përmes një mostre përfaqësuese i saktësisë së procesit të numërimit dhe vlerësimi nëse rezultatet e kontrollit krijojnë nevojë për ndërmarrjen e masave shtesë të verifikimit. Vetë aktivizimi i këtij mekanizmi nuk krijon prezumim juridik se procesi i numërimit në tërësi ka qene i pasaktë dhe as nuk mund te nënkuptohet me automatizëm si domosdoshmëri për zgjerimin e rinumërimit.

Paneli konsideron se zgjerimi i rinumërimit mund të justifikohet vetëm në rastet kur rezultatet e mostrës kontrolluese evidentojnë parregullsi të mëdha, që krijojnë dyshim objektiv, serioz dhe të bazuar lidhur me saktësinë e rezultatit zgjedhor dhe integritetin e procesit të numërimit.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar vota ndërsa kandidatë të tjerë po ashtu ne mënyrë minimale kanë humbur disa vota. Këto ndryshime nuk janë pasqyrim i një modeli të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive, por dëshmojnë se korrigjimet e evidentuara kanë qenë të shpërndara dhe nuk kanë prodhuar efekt të tillë që do të vinte në dyshim integritetin e përgjithshëm të procesit të numërimit.

Paneli më tej konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit ishin të përgjithësuara, megjithëse i është referuar për parregullsi të supozuara në QKN, ai nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi, qendër komunale të numërimit apo tavolinë numërimi jashtë mostrës së rinumëruar, për të cilat mund te vihet ne dyshim se ka pasur parregullsi. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur formularë rezultatesh, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të paraqitura gjatë procesit të numërimit apo prova të tjera konkrete që do të mbështesnin pretendimin lidhur me pasaktësitë e evidentuara në mostrën e kontrolluar apo nëse pasaktësitë e tilla mund te jene përsëritur edhe në vendvotimet e tjera.

Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se mund të ekzistojnë gabime edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel të supozimit dhe nuk mbështetet në prova konkrete.

Paneli vlerëson se procedurat e procesit zgjedhor përfshirë edhe procesin e numërimit si dhe atë te rinumërimit bazohen në parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. Për rrjedhojë, një masë e jashtëzakonshme siç është rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve të një subjekti politik në nivel vendi nuk mund të urdhërohet vetëm mbi bazën e pretendimeve hipotetike ose dyshimeve abstrakte, por vetëm atëherë kur realisht ekzistojnë fakte dhe prova

objektive që tregojnë se rezultati zgjedhor mund të jetë cenuar seriozisht nga parregullsi të evidentuara ose të përhapura në mënyrë sistematike.

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me diferencën prej vetëm 102 votash ndërmjet tij dhe kandidatit të renditur para tij, Paneli konsideron se ndonëse kjo rrethanë mund të jetë relevante për interesin individual të ankuesit, por ajo nuk mund të zëvendësojë kërkesën ligjore për paraqitjen e provave konkrete që do të justifikonin urdhërimin e rinumërimit të përgjithshëm.

Prandaj, Paneli arrin në përfundimin se ankuesi nuk ka arritur të provojë ekzistimin e rrethanave faktike dhe juridike që do të arsyetonin kalimin nga mekanizmi kontrollues i rinumërimit të mostrës së vendvotimeve në rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së në të cilin nën në mënyrë decitive thuhet se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe Nenit 13 par. 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin në mënyrë decitive thuhet se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit Kosovës Bekim Haxhiu, është e pabazuar, pasi që pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do të mundësonin konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova konkrete dhe të verifikueshme. Për rrjedhojë, në mungesë të provave konkrete, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nën në mënyrë decitive se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.52/2026 më datën 22.06.2026



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



A.A.nr.27/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija – Ymeri, dhe Albert Zogaj, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së ankuesit: Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për rinumërimin e fletëvotimeve në QNR për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 7 qershor 2026, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.52/2026, të datës 22.06.2026, në seancën e mbajtur më datë 26 qershor 2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e parashtruar nga ankuesi: Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.52/2026, të datës 22.06.2026.


A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.52/2026, të datës 22.06.2026, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.52/2026, e datës 19.06.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR, të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 qershor 2026.



Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: aplikimit të gabuar të së drejtës material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që të: I. Aprovohet e bazuar ankesa e ankuesit Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës me numër rendor 109. II. Anullohet aktvendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës me numër ZP.Anr.52/2026, duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi. III. Konstatohet se rezultatet e rinumërimit të zhvilluar në 185 vendvotime dëshmojnë ekzistencën e pasaktësive në numërimin e fletëvotimeve për kandidatët për deputet të Partisë Demokratike të Kosovës, të kryer në Qendrat Komunale të Numërimit, të cilat krijojnë dyshim objektiv mbi saktësinë e rezultateve dhe cenojnë standarde të integritetit, besueshmërisë dhe transparencës së procesit zgjedhor. IV. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të zhvillojë rinumërimin e plotë të të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës për kandidatët për deputet nga të gjitha vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar nga KQZ me vendimin numër 01/1300-2026, me qëllim verifikimin e saktësisë së rezultateve zgjedhore dhe garantimin e integritetit të procesit të numërimit. V. Obligohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që rinumërimin ta zhvillojë në Qendrën për Numërim dhe Rezultate, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, aktet nënligjore në fuqi dhe standardet e transparencës, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike dhe vëzhguesve të akredituar, duke garantuar integritetin, besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e procesit. VI. Obligohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që pas përfundimit të rinumërimit, të konstatojë rezultatet përfundimtare të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike të Kosovës në përputhje me rezultatet e rinumërimit dhe t'i përfshijë ato në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës. VII. Ky aktvendim është përfundimtar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve obligohet të ndërmarrë pa vonesë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tij.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar ka theksuar se e kundërshtojmë në tërësi ankesën e paraqitur kundër vendimit ZP.Anr.52/2026 të datës 22.06.2026, PZAP ka refuzuar ankesën e kandidatit për deputet Bekim Haxhiu për arsye se Paneli ka gjetur se KQZ me datë 17.06.2026 ka miratuar rekomandimin për numërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, përkatësisht 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta, nga



përmbajta e këtij vendimi kishte rezultuar se rinumërimi është urdhëruar si pjesë e një mekanizmi kontrollues të paraparë me legjislacionin zgjedhor, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit dhe jo si rezultat i konstatimit paraprak të parregullsive sistematike në procesin e administrimit dhe numërimit të votave. Paneli kishte vlerësuar se qëllimi i mekanizmit të paraparë me nenin 3 të Rregullores Zgjedhore numër 02/2026 është pikërisht verifikimi përmes një mostre përfaqësuese i saktësisë së procesit të numërimit dhe vlerësimi nëse rezultatet e kontrollit krijojnë nevojë për ndërmarrjen e masave shtesë të verifikimit. Tutje, ka theksuar se në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar vota ndërsa kandidatët e tjerë po ashtu në mënyrë minimale kanë humbur disa vota. Ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit nuk ishin të përgjithësuara, megjithëse i është referuar për parregullësi të supozuara në QKN, ai nuk ka identifikuar asnjë vendvotim konkret, qendër votimi, qendër komunale të numërimit, apo tavolinë numërimi jashtë mostrës së rinumëruar, për të cilat mund të vihet në dyshim se ka pasur pa rregullësi. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur formularë rezultatesh, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të paraqitura gjatë procesit të numërimit apo prova të tjera konkrete që do të mbështesnin se pretendimin lidhur me pasaktësinë e evidentuar në mostrën e kontrolluar apo nëse pasaktësitë e tilla mund të jenë përsëritur edhe në vendvotimet e tjera. Si dhe, pretendimi i ankuesit se mund të ekzistojnë gabime edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel të supozimit dhe nuk mbështetet në prova konkrete. Ndërsa sa i për këtë pretendim të ankuesit lidhur me diferencën prej vetëm 102 votash ndërmjet tij dhe kandidatit të renditur para tij, Paneli kishte konsideruar se ndonëse kjo rrethanë mund të jetë relevante për interesin individual të ankuesit, por ajo nuk mund të zëvendësojë kërkesën ligjore për paraqitjen e provave konkrete që do të justifikonin urdhërimin e rinumërimit të përgjithshëm. Krejt në fund, paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës është pabazuar pasi që pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do të mundësonin konstatimin e një shkelje zgjedhore.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.




Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 19.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.52/2026, nga Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i cili pretendon se KQZ pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit, ka konstatuar mos përputhje të evidentuara gjatë procesit të numërimit dhe për këtë arsye ka urdhëruar rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta.

Sipas të njëjtit pas përfundimit të procesit të votimit, votat e kandidatëve për deputet u numëruan në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) ndërsa rezultatet u administruan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë procesit KQZ ka konstatuar se ekzistonin rrethana që kërkonin verifikim shtesë të saktësisë së numërimit të votave për kandidatët për deputet, mbi bazën e kësaj KQZ me vendimin 01/1300-2026 urdhëroi rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta në Qendrën për Numërim dhe Rezultate. Rinumërimi përfundoi me 19 qershor dhe rezultatet e tij u publikuan nga KQZ. Mirëpo nga të dhënat zyrtare ndonëse janë rinumëruar 185 vendvotime, këto përfaqësojnë vetëm rreth 7.41% të gjithsej 2,498 vend votime në të cilat janë numëruar votat e kandidatëve për deputet në nivel vendi. Sipas rezultateve nga gjithsej 147,594 vota të fituara nga PDK janë rinumëruar vetëm 5,201 vota që përbëjnë afërsisht 3.52% të të gjithë votave të PDK-së dhe të kandidatëve të saj për deputet, dhe mbi 96.48% e votave të kandidatëve për deputet të PDK-së nuk janë verifikuar përmes procesit të rinumërimit.

Sipas ankuesit ky fakt ka rëndësi thelbësore për këtë procedurë sepse rezultati i rinumërimit nuk mund të konsiderohet verifikim gjithëpërfshirës u saktësisë së numërimit fillestar kur është kontrolluar vetëm një pjesë minimale e votave të subjektit politik.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, me vendimin ZP.Anr.52/2026, të datës 22.06.2026, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga kandidati Bekim Haxhiu, kandidat për Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.




Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga Beki Haxhiu kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qëndrorë të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në prishtinë lidur me rinumërimin e fletëvotimeve në QNR të kandidatëve për deputet nga subjekti politik PDK, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtur me datë 7 Qershor 2026.

Gjykata Supreme pretendimin e ankuesit për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e trajton si pretendim të pa bazë, sepse gjendja faktike në vendimin e atakuar është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, pasi ankuesi me ankesën e tij nuk ka bashkëngjitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij sikurse me ankesë përveç raportit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve të cilët pas rinumërimit të 185 vendvotimeve apo 7.41 % të gjithsejt vendvotimeve ka rezultuar me një gjendje të ndryshimit ku 148 vota janë më shumë për 53 kandidatë dhe 79 vota më pak për 37 kandidatë. Ankuesi tërë ankesën e tij dhe kërkesën brenda ankesës për rinumërim të tërësishëm të votave të kandidatëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës e mbështet në rezultatet e rinumërimit të bërë nga vet Komisioni Qendrorë Zgjedhor, gjë që as nuk përbën bazë të mjaftueshme për rinumërim të plotë e as provë bindëse për Gjykatën Supreme.

Pretendimet e tjera të ankuesit dhe përllogaritjet e bëra si në ankesë janë vetëm pretendime supozuese të pa mbështetura në prova konkrete apo bindëse gjë që vendimi gjyqësor nuk mund të mbështete në pretendime supozuese dhe aludime të tilla sepse pastaj nuk përbën vendim gjyqësorë.

Nuk qëndron pretendimi ankues se PZAP-i ka kërkuar në mënyrë të gabuar standard të provës absolute, por dyshim të bazuar mbështetur në prova direkte apo edhe indirekte si vendvotimet e caktuara ku janë pritshmëritë, si janë ndërtuar ato pritshmëri, pastaj raportet eventuale të OJQ-ve që kanë monitoruar procesin e votimit dhe numërimit, gjë që asnjërin nga këto ankuesi nuk e ka përmbushur me ankesën e tij.




Ankuesi e ka fare të qartë faktin e praktikës së ndërtuar dhe konsistencës së kësaj praktikë se në cilat raste PZAP-i dhe Gjykata Supreme ka urdhëruar KQZ për rinumërim, apo në cilat raste është aplikuar rinumërimi. Ankuesi në ankesë pretendon se ka prova konkrete por që nuk është e qartë se ku janë ato prova konkrete, pasi nëse i referohet vetëm vendimit të KQZ-së është provë e pamjaftueshme për të aprovuar ankesën e ankuesit dhe kërkesën për rinumërimin. Në asnjë rrethanë nuk ka arbitraritet në vendimin e atakuar të PZAP-it por ka ligjshmëri dhe diskrecion mbështetur në prova sepse është dispozita ligjore që e kufizon PZAP-in pikërisht për të mos qenë arbitrar në vendimmarrje.

Pretendimi i ankuesit se vetëm mbi bazën e gabimit të konstatuar nga KQZ-ja në rinumërim dhe rezultatit pas rinumërimit është bazë e mjaftueshme në rastin konkret, nuk vlerëson Gjykata Supreme se kjo përbën bazë të mjaftueshme në rastin konkret për një procedurë të rinumërimit. Proceset zgjedhore janë procese të shpejta, janë procese me afate kohore, ndërhyrja e PZAP-it dhe Gjykatës Supreme në këto procese vjen në shprehje vetëm në rastet e cenimit të së drejtave të kandidatëve apo subjekteve garuese, cenim ky i provuar nga ankuesi qoftë përmes provës konkrete direkte apo provë rrethanore që ngrit një dyshim të bazuar, në të kundërtën përmes këtyre pretendimeve sikurse ky në ankesë nuk përbën bazë të mjaftueshme.

KQZ-si organ që administron me procesin zgjedhor, edhe në të kaluarën ka marrë vendim për rinumërim sepse është mekanizëm i brendshëm që diktohet nga monitorimi i procesit qoftë të votimit por edhe numërimit dhe ka pasur raste që edhe në të kaluarën të ndryshoj rezultati zgjedhor për këtë është mekanizëm vetkontrollues dhe korrektues por kjo asnjëherë nuk ka përbërë bazë të mjaftueshme për të shkuar në rinumërim, nëse kandidati nuk ka provuar se mbi cilën bazë faktike e mbështet pretendimin e cenimit të së drejtës së tij, në cilat vendvotime si arrin të provojë dyshimin për manipulim në ato vendvotime etj.

Ankuesi pretendon për mos vlerësim individual të provave, ndërsa provat të cilat i ka dorëzuar janë vendimet e KQZ-së dhe se nuk ka dorëzuar asnjë provë tjetër, ndërsa pikërisht duke u vlerësuar ato vendime të KQZ-së PZAP-i ka arritur në përfundim se ankesa e ankuesit është e pa bazuar dhe se nuk ka bazë për rinumërim të tërësishëm të votave të kandidatëve nga subjekti politik PDK sikurse ka qenë pretendim ankimor i ankuesit.



Nuk qëndron pretendimi ankimor se vendimi i PZAP-it nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme vendimi i PZAP-it ka arsyetim të qartë, bindës dhe të mjaftueshëm.

Gabimet e konstatuara nga KQZ-ja në procedurë të brendshme të rinumërimit nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për rinumërim të tërësishëm sikurse pretendon ankuesi, marzha e gabimit në raport me ankuesin është minimale 0.1154 % apo rreth 0.12 %, madje nuk ekziston asnjë indikator se gabimet janë bërë qëllimshëm me u favorizuar kandidatë të caktuar dhe me u dëmtuar kandidatë të caktuar.

Fakti se ankuesi është vetëm 102 vota prapa kandidatit të fundit nga i njëjti subjekt në listë, prapë nuk përbën bazë se nga rinumërimi i tërësishëm mund të ketë ndryshim në renditje këto janë vetëm supozime pa mbështetje sepse rinumërimi i KQZ-së nuk arrin të provojë bindshëm atë që pretendon ankuesi. Vendimet gjyqësore mbështeten në prova bindëse dhe të qarta dhe jo në supozime individuale dhe përllogaritje supozuese.

Në asnjë rrethanë rezultati aktual i rinumërimit të KQZ-së nuk përbën bazë të mjaftueshme për rinumërim të tërësishëm, e as praktika juridike zgjedhore në Kosovës si e PZAP-it por edhe Gjykatës Supreme nuk njeh raste kur vendimi për rinumërim është mbështetur ekskluzivisht vetëm në një fakt të tillë sikurse në rastin konkret.

Ankuesi duke iu referuar praktikës së Gjykatës Supreme si në rastin e Komunës së Istogut vërteton faktin se në cilat raste shkohet në rinumërim, gjë që nuk ka aspekte identike faktike si në rastin konkret, pasi në rastin e referuar me ankese kanë qenë kontestuese vendvotime të caktuara dhe kur është provuar nga ankuesit, por rrethanat nuk janë të njëjta e as rasti. Pretendimi i ankuesit është i përgjithshëm pa specifikim konkret se në cilat vendvotime pretendon se numri i votave që do të duhej të merrte është më i madh sesa numri që rezulton në numërim, ku e mbështet këtë fakt, dhe jo të mjaftohet vetëm në konstatimet e rinumërimit të KQZ-së.

Interesi qytetar i pretenduar nga ankuesi nuk nënkupton interesin personal sepse ankuesi nuk ka provuar se “votuesit e mundshëm të vendvotimeve në qendra apo vendvotime të caktuara” pretendojnë se vota e tyre është manipuluar dhe nuk ka shkuar aty ku ka qenë qëllimi i tyre destinues për ankuesin. Pra ky është një pretendim pa asnjë mbështetje juridike.


Rinumërimi në rastin konkret nuk është masë proporcionale sikurse pretendon ankuesi pasi në njëërën anë kemi një proces zgjedhor që është proces me afate të shkurtra dhe të qarta, kemi standarde ndërkombëtare që inkurajojnë që sa më shpejt të përfundohet procesi me certifikim të rezultateve, në anën tjetër kemi numër minimal të ankesave që i referohen “gabimeve apo manipulimit në numërim të votave”, kjo nuk përbën masë proporcionale, e kundërta e proporcionalitetit është rinumërimi sikurse në rastin konkret mbështetur vetëm në rezultatin e KQZ-së pas rinumërimit të pjesshëm.

Në këtë procedurë është kontestuar rezultati individual i numërimit dhe jo ligjshmëria sepse ankuesi në rastin konkret nuk përfaqëson të gjithë kandidatët nga subjekti politik të cili i takon dhe nuk mund të flas as të kërkojë në emër të tyre, pasi secili prej kandidatëve ka pasur mundësi të kontestojë rezultatin sikur të qëndronte pretendimi i ankuesit.

Rinumërimi i kërkuar cenon stabilitetin zgjedhor dhe ndikon dukshëm në perceptimin, integritetin dhe kredibilitetin e procesit zgjedhor të tërësishëm proces ky që nuk është kontestuar nga subjektet politike pjesëmarrëse (duke përfshirë edhe subjektin politik të cilit i përket ankuesi) por nga individët apo kandidatët brenda subjekteve që në numër janë numri minimal i mundshëm. Andaj pranimi i procesit zgjedhor të numërimit si proces i drejtë nga shumica absolute, nuk përbën bazë për rinumërim nga pakica individuale sepse nuk mbështet në prova bindëse dhe të qarta por vetëm në një provë të vetme që rezulton se në rastin konkret është bazë e pamjaftueshme për të dërguar në rinumërim të tërësishëm të votave të kandidatëve nga subjekti të cilit i përket ankuesi.

Rastet nga praktike e GJEDNJ-së të cilave i është referuar ankuesi nuk kanë lidhje substanciale dhe përmbajtjesore me rastin në fjalë, pasinë rastin konkret nuk vlerësim e as vendim arbitrar nga PZAP-i në raport me ankesën e ankuesit, diskrecioni ka qenë i ligjshëm i drejtë dhe i mbështetur në vlerësim të drejtë të gjendjes dhe jo i pakufizuar apo arbitrar, ankuesi nuk ka paraqitur prova bindëse për argumentimin e pretendimeve nga ankesa.

Nuk qëndron pretendimi ankues në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme PZAP-i me vendimin e atakuar ka vendosur drejtë dhe zbatuar drejtë të drejtën materiale që i referohet Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores së PZAP-së nr.01/2025.



Me nenin 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcaktohet: “PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht.”, ndërsa me nenin 13 par.4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it përcaktohet: “PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa ose grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

As.A.m. 17/2026, me datë 26 qershor 2026.



SAKTESINË E KOPJES E VËRTETON
TAŠNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćenj radnik

Kryetar i kolegjit,
Faton Ademi